



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIATEVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIATEVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

22 -03- 2021

Ref. 2103/359/BA/yf



Nr.16/2021

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2103/309/BA/yf/ të datës 10.03.2021 të parashtruesit “Klan Kosova” SH.P.K. të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2102/162/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar Ankesa Ref:2103/309/BA/yf/ të datës 10.03.2021 të parashtruesit “Klan Kosova” SH.P.K. dhe mbetet në fuqi Vendimi Ref:2102/162/KPM/xhl, i datës 11.02.2021 i Komisionit të Pavarur të Mediave.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/162/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 Palën përgjegjës “Klan Kosova” SH.P.K e ka sanksionuar me vërejtje në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, për shkeljen e nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “Klan Kosova” SH.P.K. ka parashtruar Ankesë Ref:2103/309/BA/yf me datën 10.03.2021 pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shqiptimit të sanksionit dhe i ka propozuar BA të anulojë këtë Vendim ose të njëjtin ta rikthejë në shkallën e parë në rishqyrtim dhe rivendosije.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Klan Kosova” SH.P.K. si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref:2102/162/KPM/xhl, e datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, duke u bazuar në dispozitat materiale dhe procedurale që rregullojnë fushën e Komisionit të Pavarur të Mediave.


Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 i Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.




Ylber Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa